

SOT

qeveria shqiptare për të shlyer detyrimet e prapambetura të institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore të faturave ndaj kompanive të sektorit publik të energjisë. Strategjia përcakton një mekanizëm të shlyerjes më kompesim të...

LEXO TË PLOTË...

gjueti pasurive të dyshimta

Kupola e drejtësisë shqiptare me pasuri marramendëse, makina luksoze dhe vila në bregdet

Rekrutimi i shtetasve për në SH, goditja e bashkëpunësve në Kosovë, arrestimi i 2 kriminelë të vëllimshëm dhe 6 besniktarë

SHIKO TË GJITHA

SHARE

PROGRAMI AGROKAPITAL, PANARITI: DHËNIA E CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË LEHTËSON PROCESIN E KREDITIMIT TË BUJQËSISË

AKTUALITET

Creative Business Solutions CBS në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) paraqitën programin AgroKapital, për rritjen e financimit për agrobiznesin...

LEXO MË SHUMË --

MË TË LEXUARAT

| Të ditës | Të javës | Të muajit |
|---|----------|-----------|
| Kupola e drejtësisë shqiptare me pasuri marramendëse, makina luksoze dhe vila në bregdet (305 lexime) | | |
| Hyn në fuqi vendimi për administratën, nga sot kriteret e reja për nëpunësit civilë, ja sistemi i ri i vlerësimit (235 lexime) | | |
| Deputetët e PS kontroll Visho Likës, kreu i SHISH drejt fatit të Zana Xhukës, Komisioni i Sigurisë kërkon të hapë dyert e SHISH (202 lexime) | | |
| Hetimi i pasurive të pushtetarëve në 4 faza, "Pastrimi i Parave", Prokuroria dhe ILDKP gjueti pasurive të dyshimta | | |

Roma > Shkup

www.flyalbania.eu

Programi AgroKapital, Panariti: Dhënia e çertifikatave të pronësisë lehtëson procesin e kreditimit të bujqësisë

SHARE



Creative Business Solutions CBS në partneritet me Agjensinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) paraqitën programin AgroKapital, për rritjen e financimit për agrobiznesin shqiptar sot në një takim të zgjeruar në Tiranë. Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave z. Edmond Panariti, duke vlerësuar rëndësinë e financimit për bujqësinë, tha se: "Duhet të heqim dorë nga skemat mbështetëse për bujqësinë e mbijetesës dhe nga skemat që favorizojnë klientelizmin dhe abuzimet. Duhet të ndryshojmë mentalitetin e krijuar deri tani: Bujqësia nuk është sektor që kërkon asistencë sociale, dhe fondet nuk duhet të shkojnë si lëmoshë dhe asistencë për fermerët. Bujqësia kërkon fonde për zhvillim, investim në teknologji moderne, për krijimin e pikave të grumbullimit, magazinave frigoriferike etj. Një nga pengesat për zhvillimin e bujqësisë, ka qenë pamjaftueshmëria e financimeve. Kjo situatë vjen edhe për shkak të shkallës së lartë të informalitetit në bujqësi dhe pikërisht për këtë është angazhuar Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Bujqësisë, pra për të formalizuar këtë sektor. Dhe në këtë drejtim objektivi i parë është iniciativa për të çuar në finale ligjin 7501, për të dhënë certifikatat e para të pronësisë, pasi në këtë mënyrë, hapet tregu i tokës dhe fermerët e kanë më të lehtë për të vendosur tokën si kolateral në bankë dhe për të marrë kredi që të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Pra dhënia e certifikatave të pronësisë lehtëson procesin e kreditimit të bujqësisë", u shpreh Panariti.

Nga ana e tij Drejtori Ekzekutiv i Misionit USAID në Shqipëri, z. David L. Cowles e vlerësoi sektorin e bujqësisë në Shqipëri si sektor me impakt të jashtëzakonshëm në uljen e varfërisë, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të ardhurave. Në krahasim me vendet e tjera të Europës tha ai, sektori i bujqësisë në Shqipëri prodhon 23 % të GDP, që përfaqëson 40% të punësimit total në vend. "Ka patur një progres në këtë sektor por sfidat janë ende shumë domethënëse. Rajoni po mundohet të marrë veten nga impakti i situatës së krizës në Eurozonë. Kriza ka patur impakt në kredidhënie duke bërë institucionet financiare të reduktojnë aksesin në kapital për agropërpunuesit. Ne përgjigje të kësaj situatë, USAID ka nënshkruar marrëveshje me dy banka dhe 2 organizata, AAC Lushnje dhe CBS, për përmirësimin e financimit të agrobiznesit. Duke punuar me të dy palët, si me bankat ashtu edhe me agropërpunuesit, ne besojmë, theksoi ai, se do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e kredidhënies për sektorin e bujqësisë. Une besoj fuqimisht se do të gjeni tek CBS një partner të fortë për të përmirësuar financimin në sektorin e bujqësisë".

Programi AgroKapital ka objektiva ambicioze dhe ka filluar punën fuqishëm, por sukcesi i këtij programi përfshin të gjithë aktorët: insitucionet financiare, projektet kombëtare dhe nderkombëtare, qeverinë, dhe investitorë të cilët do të jenë partnerët tanë përgjate programit. Enio Jaço, Drejtori Ekzekutiv i CBS në prezantimin e tij theksoi se AgroKapital do të shërbejë si hallka lidhëse midis komunitetit të agrobiznesit shqiptar dhe bankave e institucioneve financiare si injektorë të kapitaleve në ekonominë bujqësore. 'Rritja e kreditimit dhe rritja e aftësisë menaxhuese të sipërmarrjeve bujqësore janë qëllimet më të rëndësishme të projektit', nënvizoi Drejtori Ekzekutiv i CBS. Enio Jaço tha se 'Programi AgroKapital do të rrisë investimet në Agrobiznes nëpërmjet financimeve, me 18.5 milion USD, si dhe do të rrisë xhiron e sipërmarrjeve të mbështetura nga programi, me 28 milion USD duke gjeneruar mbi 1,150 vende të reja pune'. Përfaqësues të lartë të Qeverisë, Drejtues të Bankave dhe Institucioneve Financiare, ekspertë, donatorë dhe investitorë, diskutuan mbi mundësitë e reja të financimit, të cilat tashmë i ofrohen agrobiznesit shqiptar përfshirë mbështetjen nga programi AgroKapital, nga skemat financuese të donatorëve si dhe nga produktet e reja bankare.

- See more at: <http://www.sot.com.al/aktualitet/programi-agrokapital-panariti-dh%C3%ABnia-e-%C3%A7ertifikatave-t%C3%AB-pron%C3%ABsis%C3%AB-leht%C3%ABson-procesin-e#sthash.OPkk8YNv.dpuf>